



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2207/Prot.

7

Tiranë, më 18.08.2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 57, datë 18.08.2023

PËR

**“PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE BUXHETORE NË  
BUXHETIN E VITIT 2023, PËR SHPENZIME BURSA PËR STUDENTËT E  
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të Ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2018 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.10296, 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Rregullores së Brendshme, të ndryshuar “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Vendimit të Bordit të Administrimit nr.38 datë 02.05.2023 “Miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2023 për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të MAS-së nr.4510/1 prot., datë 19.07.2023, Vendimit të Dekanatit të FSHMT-së nr.26 datë 26.07.2023, relacionit nr.2207/5 prot., datë 28.07.2023 dhe relacionit nr.2207/6 prot., datë 16.08.2023 të Administratorit të UMT-së, “Kërkesë për rishpërndarje fondesh buxhetore për bursa dhe shtesë në buxhetin e vitit 2023, për studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve buxhetore për vitin 2023, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETAR  
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT YZEIRAJ